



# Si të siguron burimet për t'u veçuar të sigurt në shtëpi

NYC Test & Trace Corps do të sigurohet që cilido që ka pasur COVID-19 apo që ka qenë në kontakt me dikë me COVID-19, të ketë burimet për t'u veçuar në mënyrë të sigurt në shtëpi. Për këtë gjë, ne punojmë me orientuesit e burimeve nga organizatat me bazë komuniteti në lagjen tuaj. Ata mund t'ju ndihmojnë të përfitoni nga burimet në lagjen tuaj.

## Burimet përfshijnë:

- + dërgesat ushqimore
- + lejen e paguar nga punëdhënësi juaj
- + barnat
- + sigurimin shëndetësor
- + shërbimet bazë (korrentin, ujin, gazin)
- + ndihmën për të marrë urdhër formal për karantinë
- + një ofrues të kujdesit parësor
- + mbështetje për shëndetin mendor
- + ndihmë kundër dhunën në familje
- + shërbime shoqërore
- + burime strehimi dhe për të pastrehë
- + përkujdesje për kafshët shtëpiake
- + paketë përkujdesjeje me pajime të mjaftueshme mbrojtëse për një shtëpi me tre vetë për karantinë/izolim për 10-14 ditë.
- + dhe shumë të tjera!

Për të kontaktuar me orientuesin e burimeve, telefononi nr. **1-212-COVID19 (1-212-268-4319)**, shtypni 5 për ndihmesë në veçimin në mënyrë të sigurt dhe shtypni 5 për t'u larguar nga posta zanore për burime të tjera. Orientuesi i burimeve do t'ju marrë mbrapsht në telefon. Nëse jeni pjesë e programit Test and Trace mund t'i kërkonti **Shqyrtuesit ose monitoruesit të rastit tuaj** të flasë me një orientues burimesh në çfarëdo kohe.

**Komunikimi me një orientues të burimeve nuk jua cenon mundësinë e aplikimit për qëndrim të përhershëm (apo "kartën e gjelbër").** Nëse keni pyetje për statusin tuaj të imigrimit, telefonojini linjës së ActionNYC në nr. 1-800-354-0365 dhe thoni "public charge" (faturim publik) nga ora 9 a.m. deri në 6 p.m., nga e hëna në të premte.

**Organizatat partnere përfshijnë:** Bronxworks, Consortium for Worker Education (CWE), Bed-Stuy Restoration, Northern Manhattan Improvement Corporation (NMIC), Make the Road NY, SoBro, Urban Upbound, Riseboro, JCC of Staten Island, CUNY dhe Chinese-American Planning Council (CPC) në partneritet me Mekong NYC, dhe Korean Community Services.

Informacioni që NYC Test & Trace Corps merr përmes gjurmimit të kontakteve është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju-Jorkut. Databaza e Corps nuk do të lidhet me ndonjë databazë autoritetesh ligjzbatuese. NYC Test & Trace Corps do të ruajë në formë të siguruar çfarëdo informacioni që marrim dhe atë do ta përdorë vetëm personeli i autorizuar për qëllimin e kufizuar të mbrojtjes së shëndetit publik.

Për më shumë,  
vizitoni [testandtrace.nyc](https://testandtrace.nyc)

NYC  
HEALTH+  
HOSPITALS

Test & Trace  
Corps

# Çfarë mund të bëni për të luftuar COVID-19

## TESTIM




Mësoni statusin tuaj. Përfitoni një test për COVID-19 pa kosto për ju.

## GJURMIM



Përgjigjuni thirrjes së gjurmuesve tanë të kontakteve për të ndihmuar ndalimin e përhapjes së COVID-19 në komunitetin tuaj.

## PËRKUJDESJE



Veçohuni në mënyrë të sigurt për të mbrojtur të tjerët dhe merrni përkujdesje në hotel apo në shtëpi.

NYC Test & Trace Corps është e përkushtuar në mbrojtjen e privatësisë dhe të sigurisë së informacionit tuaj personal dhe shëndetësor. I gjithë informacioni që marrim është konfidencial dhe i mbrojtur sipas Kodit Shëndetësor të qytetit të Nju-Jorkut. Test & Trace Corps nuk do të pyesë për statusin e imigrimit të askujt.

**NYC**  
**HEALTH+**  
**HOSPITALS**

 **Test & Trace  
Corps**